

Autoriteti kontraktues:

Instituti Demokratik i Kosovës - Transparency International Kosova

Udhëzues për aplikantët

Thirrje e hapur për sub-grante për OSHC-të në Kosovë

**“Integrity Watch në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi:
shoqëria civile lufton korrupsionin me të dhëna të
integritetit politik”**

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve:

16 korrik 2025

Tabela e përmbajtjes

1.	HYRJE	3
2.	SFONDI I PROJEKTIT DHE QËLLIMI I THIRRJES	3
3.	QËLLIMI, AKTIVITETET DHE NDIKIMI I PRITUR	4
4.	BUXHETI DHE SHUMA E GRANTEVE	5
5.	PËRMBUSHJA E KRITEREVE NGA APLIKANTËT	5
6.	AFATET KOHORE	6
7.	SI TË APLIKONI	6
7.1.	Dokumentet e aplikimit	7
8.	KËRKESAT E THIRRJES	7
9.	PROCESI DHE KRITERET E PËRZGJEDHJES	10
9.1.	Shqyrtimi fillestar i aplikacioneve	11
9.2.	Vlerësimi dhe përzgjedhja	11
9.3.	Njoftimi i aplikantëve	12
10.	MENTORIMI DHE RAPORTIMI	12

1. HYRJE

Veprimi “Integrity Watch në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi: Shoqëria civile lufton korrupsionin me të dhëna të integritetit politik” (në tekstin në vijim referuar si IW WBT) financohet në kuadër të Programit të BE-së për Shoqërinë Civile dhe Media në favor të Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë për 2021-2023 (IPA III) në kuadër të llotit “Qeverisja e Mirë, Sundimi i Ligjit dhe Anti-korrupcioni”. Është një veprim trevjeçar i financuar nga Komisioni Evropian, nga marsi 2023 deri në shkurt 2026 (IPA/2022/440-922).

2. SFONDI I PROJEKTIT DHE QËLLIMI I THIRRJES

Kjo thirrje e hapur publikohet në kuadër të projektit Integrity Watch i cili është duke u zbatuar në Kosovë, Bosnjë dhe Hercegovinë, Maqedoninë e Veriut, Serbi dhe Turqi. Kjo është një nismë rajonale në fushën e integritetit politik, e udhëhequr nga Instituti Demokratik i Kosovës - Transparency International Kosova, në partneritet me Sekretariatit e Transparency International me seli në Gjermani, Transparency International në Bosnjë dhe Hercegovinë, Transparency International Maqedoni, Transparency Serbia dhe Transparency International Türkiye, të cilat përbëjnë Konsorciumin Integrity Watch.

Iniciativat rajonale kundër korrupsionit, të udhëhequra nga shoqëria civile, kanë identifikuar cenueshmëritë e integritetit politik, si sfida kyçe e korrupsionit në mbarë rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe Turqi. Cenueshmëritë kryesore u mundësojnë interesave të zotëruara (krimi i organizuar, bizneset e korruptuara ose politikanët e korruptuar) mundësitë për të zgjedhur mekanizmat për (i) t’iu qasur pushtetit (zgjedhje dhe emërimet), (ii) vendimmarrje ('ligjet e përshtatura' dhe kontraktimet publike) dhe (iii) gjyqësor. Mungesa e të dhënave ose përdorimi i pamjaftueshëm i informacionit se kush e financon politikën, kush ndikon në ligjëbërjen dhe se si ndahen burimet publike, kombinuar me bashkëpunimin e ulët midis akterëve me prirje reformash brenda vendit dhe në mbarë rajonin, parandalon llogaridhënien, lë rastet e abuzimit të pazbuluara dhe kontribuon drejtpërdrejt në nivele të larta të korrupsionit politik. Korrupsioni në politikë çon në shembjen e besimit të qytetarëve në proceset vendimmarrëse, mungesa e mekanizmave adekuat për t'i mbajtur politikanët përgjegjës për integritetin politik.

Me synim për të fuqizuar qytetarët dhe akterët e shoqërisë civile në Ballkanin Perëndimor (Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Maqedoni e Veriut dhe Serbi) dhe Turqi për të kërkuar llogari nga mbajtësit e posteve politike, IW WBT është fokusuar në tri fushat më të rëndësishme për anti-korrupsionin dhe integritetin politik në rajon: paqartësia e financave politike, ndikimi i panevojshëm i interesave të veshura në ligjëbërje, dhe favorizimi në kontraktimet publike. Duke përdorur të dhëna të hapura për transparencën dhe llogaridhënien, programi synon të forcojë integritetin në financimin politik, vendimmarrjen legjislative dhe shpërndarjen e burimeve publike, të luftojë korrupsionin politik duke angazhuar akterët kryesorë të shoqërisë civile dhe institucionet mbikëqyrëse, si dhe të promovojë qeverisjen demokratike dhe angazhimin qytetar. Ai promovon drejtpërdrejt angazhimin midis akterëve të shoqërisë civile dhe organeve kryesore të mbikëqyrjes, zbatimit të ligjit dhe vendimmarrjes për i) përmirësimin e aftësisë së autoriteteve shtetërore, shoqërisë civile dhe medias për të zbuluar dhe parandaluar rreziqet e korrupsionit politik duke përdorur të dhëna të hapura, dhe ii) për të rritur shkëmbimet e brendshme dhe ndërkufitare midis akterëve përkatës në autoritetet shtetërore, shoqërinë civile dhe mediat për të zbuluar, parandaluar dhe luftuar korrupsionin politik.

Përmes kësaj thirrje për aplikime, nga aplikuesit pritet që të propozojnë nisma kreative të cilat fuqizojnë apo nxisin përdorimin e të dhënave publike për të identifikuar dhe për të nxjerr në pah rreziqet e korrupsionit politik, duke avokuar për transparencë, llogaridhënie dhe integritet në Kosovë.

3. QËLLIMI, AKTIVITETET DHE NDIKIMI I PRITUR

Qëllimi i thirrjes

Kjo thirrje e hapur synon të shfrytëzojë të dhënat publike për integritetin publik në Kosovë, raportet hulumtuese të publikuara përmes këtij projekti (përfshirë raportin për të dhënat e integritetit politik në Kosovë dhe raportin vlerësues mbi kornizën ligjore të integritetit politik në Kosovë), si dhe partneritetet me institucionet mbikëqyrëse dhe mediat për të zbuluar dhe trajtuar rreziqet e korrupsionit në financat politike, ligjbërjen dhe prokurimin publik.

Raportet hulumtuese të publikuara nga KDI në lidhje me çështjet që ndërlidhen me integritetin politik në Kosovë mund t'i gjeni në vegëzat e mëposhtme:

- Raporti “*Integriteti politik: Çfarë të dhënash kemi? Shtrirja e të dhënave të ndërlidhura me integritetin politik në Kosovë*”: <https://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2023/09/Shtrirja-e-te-dhenave-te-nderlidhura-me-integritetin-politik-ne-Kosove-Raporti.pdf>
- Raporti “*Zbulimi i dobësive: Një shqyrtim kritik i rregullativës për integritetin politik në Kosovë*”: <https://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2025/04/02-Raport-Kosovo-Regulation-Assessment-ALB-ISBN.pdf>

Aktivitetet dhe ndikimi i pritur

Aplikantët pritet të propozojnë nisma që prodhojnë rezultate të matshme, duke përfshirë veprime avokuese, ndërgjegjësimin qytetar, aktivitete hulumtuese dhe përfshirjen e palëve të interesit.

Nga aplikantët pritet të dëshmojnë rezultate konkrete në të paktën një nga fushat në vijim: financimi politik, procesi ligjvënës dhe prokurimi publik:

- **Aktivitete avokimi:** Organizimi i takimeve publike, konsultimeve dhe ngjarjeve që angazhojnë qytetarët, institucionet dhe median, si dhe të promovojnë transparencën dhe llogaridhënien.
- **Ndikimi në komunitet:** Përmirësimi i ndërgjegjësimit dhe përfshirjes së qytetarëve mbi integritetin politik, veçanërisht në mesin e grupeve të nën-përfaqësuar si gratë, të rinjtë dhe minoritetet.
- **Hulumtime:** Raporte, artikuj dhe përmbajtje të tjera që identifikojnë, ekspozojnë dhe propozojnë zgjidhje për rreziqet e integritetit politik
- **Angazhimi i palëve të interesit:** Ndërtimi i bashkëpunimit efektiv me institucionet publike dhe vendimmarrësit për të forcuar standardet e llogaridhënies dhe qeverisjen e mirë.

Periudha e zbatimit për projektet e propozuara mund të jetë nga katër (4) deri në maksimum gjashtë (6) muaj. Zbatimi i granteve duhet të fillojë jo më herët se më 15 gusht 2025 dhe të përfundojë jo më vonë se më 15 shkurt 2026.

Aktivitetet e pranueshme kategorizohen si më vijim:

(a) Krijimi dhe shpërndarja e njohurive

Aktivitete që synojnë krijimin dhe shkëmbimin e njohurive të bazuara në dëshmi, për të mbështetur avokimin për integritetin politik, duke përfshirë, por pa u kufizuar në:

- *Përgatitjen dhe hartimi i raporteve, përmbledhjeve të politikave, analizave, opinione/editorialeve (op-eds) etj., bazuar në të dhëna të hapura për integritetin politik në Kosovë;*
- *Zhvillimi dhe publikimi i materialeve për rritjen e vetëdijes, si infografika dhe përmbajtje digjitale, bazuar në të dhëna dhe hulumtime përkatëse për integritetin politik.*
- *Identifikimi i të grupit të të dhënave (datasets) të reja për integritetin politik dhe propozimi i referencimit të të dhënave të integritetit politik për të zbuluar dhe ekspozuar rreziqet e korrupsionit.*

(b) Veprimet e avokimit dhe vizibiliteti

Aktivitetet e projektuara për të shfrytëzuar të dhënat e integritetit politik të krijuara ose publikuara në kuadër të projektit për të promovuar llogaridhënien, për të rritur ndërgjegjësimin e publikut dhe për të forcuar standardet e integritetit. Si shembuj mund të përfshihen:

- *Organizimi i ngjarjeve publike, siç janë debatet, forumet dhe diskutimet në panel me palët e interesuara*
- *Lehtësimi i rrjetëzimit dhe konsultimeve me palët e interesit, përfshirë politikëbërësit, shoqërinë civile, mediat dhe qytetarët për aktivitetet e avokimit të përqendruara në përmirësimin e integritetit politik;*
- *Zbatimi i nismave të angazhimit qytetar për të nxitur dialogun dhe pjesëmarrjen, bazuar në të dhëna;*
- *Publikimi i aktiviteteve të avokimit, krijimi i përmbajtjes në mediat sociale dhe përpjekje të tjera për dukshmëri (vizibilitet) me qëllim të zgjerimit të ndikimit të avokimit për integritetin politik;*
- *Organizimi i seminareve ndërsektoriale për të forcuar bashkëpunimin midis OSHC-ve, mediave dhe institucioneve.*

4. BUXHETI DHE SHUMA E GRANTEVE

Shuma e përgjithshme e disponueshme në kuadër të thirrjes për propozime në Kosovë është 44.000 euro. Do të jepen të paktën 5 sub-grante, derisa shuma e grantit mund të jetë prej shumës minimale 4.000 euro dhe asaj maksimale 12.000 euro, varësisht nga kohëzgjatja dhe fushëveprimi i propozuar i nismave.

Një aplikues nuk mund të dorëzojë më shumë se një (1) aplikacion në kuadër të kësaj thirrje.

*** Shuma e përgjithshme e sub-granteve e disponueshme përmes kësaj thirrjeje në pesë vende të synuara (Kosovë, Bosnjë dhe Hercegovinë, Maqedoni e Veriut, Serbi dhe Turqi) është 220,000 euro për të paktën 25 sub-grante.

5. PËRMBUSHJA E KRITEREVE NGA APLIKANTËT

Entitetet e pranueshme për mbështetje financiare në kuadër të kësaj thirrjeje janë organizatat vendase jofitimprurëse dhe joqeveritare të shoqërisë civile (OJQ) të regjistruara në Kosovë.

Aplikantët duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme për t'u kualifikuar për grant:

- Të jetë entitet juridik i regjistruar të paktën tre (3) vite para datës së shpalljes së kësaj thirrjeje.
- Të jetë i regjistruar në Kosovë.

Aplikantët e kualifikuar pritet të dëshmojnë kapacitete për të menaxhuar projektet me përgjegjësi dhe për të kontribuar në mënyrë domethënëse për qëllimet e programit përmes propozimeve të projektuara mirë dhe të harmonizuara.

Ne inkurajojmë aplikimet nga organizatat me bazë në komunitet dhe ato që punojnë me grupe të nën-përfaqësuar si të rinjtë, gratë, LGBTI+ ose pakicat etnike.

Për t'u kualifikuar, aplikacionet duhet të përmbushin kriteret e mëposhtme:

- **Vendndodhja:** Aktivitetet e propozuara duhet të zbatohen në Kosovë.
- **Harmonizimi me objektivat e projektit:** Propozimet duhet të kontribuojnë drejtpërdrejt në objektivat e projektit IË ËBT, duke u përqendruar në transparencë, llogaridhënie, luftën kundër korrupsionit dhe promovimin e qeverisjes së mirë.
- **Kërkesat për kapacitet:** Aplikantët duhet të dëshmojnë kapacitetin e tyre organizativ për të menaxhuar sub-grantin në mënyrë efektive, përfshirë menaxhimin financiar, zbatimin e projektit dhe raportimin.
- **Përgjegjësia e drejtpërdrejtë:** Aplikanti duhet të jetë drejtpërdrejt përgjegjës për përgatitjen dhe menaxhimin e projektit, dhe jo të veprojë si ndërmjetës.

6. AFATET KOHORE

- | | |
|--|---------------------------------------|
| • Publikimi i thirrjes: | 17 qershor 2025 |
| • Sesi informues: | 24 qershor 2025 |
| • Afati i aplikimit: | 16 korrik 2025 |
| • Procesi i vlerësimit: | 17 korrik - 7 gusht 2025 |
| • Shpallja e rezultateve: | 8 gusht 2025 |
| • Datat e fillimi dhe përfundimi të projektit: | 15 gusht 2025 - 15 shkurt 2026 |

Shënim: Afatet kohore mund të pësojnë ndryshime.

7. SI TË APLIKONI

OSHC-të që aplikojnë për sub-grante duhet të plotësojnë kriteret e pranueshmërisë, qëllimin e thirrjes dhe të ndjekin me kujdes procesin e aplikimit.

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve është **16 korrik 2025, në ora 23:59, sipas kohës lokale në Kosovë**. Dokumentet e aplikimit duhet të dërgohen vetëm në formë elektronike në gjuhën shqipe, serbe apo angleze në e-mailin: info@kdi-kosova.org.

Aplikacioni i pranuar pas afatit nuk do të shqyrtohet dhe do të refuzohet.

Për të siguruar qartësi, qëndrueshmëri dhe krahasueshmëri në procesin e vlerësimit të propozimeve, të gjitha organizatat aplikuese duhet të përdorin format standarde të aplikimit. Këto dokumente i ndihmojnë aplikantët të përshkruajnë idetë dhe nevojat e tyre në mënyrë të strukturuar dhe lehtësojnë shqyrtimin nga vlerësuesit.

Përdorimi i këtyre formave standarde siguron një proces transparent dhe të barabartë për të gjithë aplikantët. Aplikantët duhet të plotësojnë format e ofruara të aplikimit pa bërë ndryshime në strukturën ose përmbajtjen

e tyre. Dokumentet e plotësuara duhet të dorëzohen brenda afateve të përcaktuara, sipas udhëzimeve të thirrjes.

7.1. Dokumentet e aplikimit

Aplikantët duhet të dorëzojnë dokumentet e mëposhtme të aplikimit:

- Aneksi A: Formulari i aplikimit.
- Aneksi B: Formulari i buxhetit.
- Certifikata e regjistrimit të OJQ-së.

i. Aneksi A: Formulari i aplikimit

Përmbajtja: Ky formular përfshin seksione të detajuara për të përshkruar, të paktën, komponentët e mëposhtëm:

- Objektivi i projektit.
- Rezultatet e pritshme.
- Aktivitetet kryesore, afatin kohor dhe qasjen.
- Harmonizimi me objektivat e thirrjes.

Rëndësia: Siguron që informacionet të jenë të organizuara dhe të lehta për t'u shqyrtuar nga komisioni i vlerësimit.

ii. Aneksi B: Formulari i buxhetit

Përmbajtja: Ky formular kërkon që aplikantët të sigurojnë një llogaritje të detajuar të shpenzimeve të propozuara, duke përfshirë:

- Shpenzimet për aktivitete specifike.
- Shpenzimet administrative dhe operative.
- Bashkëfinancimin (nëse është e aplikueshme).

Formulari i buxhetit (Aneksi B) duhet të përgatitet dhe ndarjet buxhetore të bëhen si në vijim:

- Nga aplikantët kërkohet të ndajnë të paktën **60%** të buxhetit total të propozuar për aktivitetet e drejtpërdrejta të projektit (kostoja e aktivitetit), duke përfshirë zbatimin e projektit, ngjarjet, materialet, udhëtimin dhe kostot e tjera të lidhura me të.
- Deri në **40%** e buxhetit total mund të ndahet për shpenzimet e burimeve njerëzore (p.sh. paga, mëditje) dhe kostot administrative që mund të jenë thelbësore për menaxhimin dhe administrimin efektiv të projektit.

Rëndësia: Ndihmon në vlerësimin e qëndrueshmërisë financiare dhe përshtatshmërisë së buxhetit në lidhje me objektivat dhe rezultatet e pritura të projektit.

8. KËRKESAT E THIRRJES

Në kuadër të këtij programi do të mbështeten ndërhyrjet dhe aktivitetet e mëposhtme:

- **Përputhshmëria me objektivat e projektit:** Aktivitetet dhe shpenzimet duhet të përputhen drejtpërdrejt me qëllimet dhe objektivat e përgjithshme të projektit. Ato duhet të kontribuojnë në arritjen e rezultateve të synuara si dhe të intervenimit/ndërhjës.
- **Rezultatet e projektit:** Aktivitetet duhet të jenë thelbësore për zbatimin e projektit dhe arritjen e rezultateve të tij. Të gjitha shpenzimet duhet të lidhen drejtpërdrejt me ekzekutimin e aktiviteteve të miratuara.
- **Efektiviteti i shpenzimeve dhe justifikimi:** Shpenzimet duhet të jenë të arsyeshme, të justifikuara dhe proporcionale me rezultatet e pritura. Praktikën e menaxhimit me kosto efektive duhet të zbatohen për të siguruar që fondet përdoren në mënyrë efikase.
- **Pajtueshmëria me kërkesat ligjore dhe rregullatore:** Të gjitha aktivitetet dhe shpenzimet duhet të jenë në përputhje me ligjet, rregullativat dhe kërkesat fiskale në fuqi, duke përfshirë legjislacionin tatimor, dhe duhet të mbështeten nga dokumentacioni i duhur.
- **Përputhja me buxhetin e miratuar:** Aktivitetet dhe shpenzimet duhet të parashikohen dhe miratohen në buxhetin e projektit, të vërtetuara nga autoritetet përkatëse.
- **Gjurmimi dhe transparencë:** Të gjitha aktivitetet dhe shpenzimet duhet të jenë të gjurmueshme përmes dokumentacionit të duhur, duke përfshirë faturat, kontratat dhe raportet financiare, për të garantuar transparencë dhe llogaridhënie.

Ndërhjësjet dhe aktivitetet e mëposhtme nuk do të mbështeten në kuadër të këtij programi:

- **Aktivitetet që lidhen drejtpërdrejt me partitë politike:** Nuk do të konsiderohen për financim aktivitetet që synojnë mbështetjen e partive politike ose të lidhura drejtpërdrejt me aktivitetet e tyre elektorale.
- **Mbështetja për kandidatët dhe fushatat zgjedhore:** Do të jenë të papranueshme ndërhjësjet që mbështesin kandidatët për zgjedhjet politike ose që janë të lidhura drejtpërdrejt me fushatat zgjedhore.
- **Aktivitetet në kundërshtim me vlerat themelore të BE-së:** Nuk do të mbështeten aktivitetet që bien ndesh me vlerat themelore të Bashkimit Evropian, si demokracia, sundimi i ligjit dhe të drejtat e njeriut.
- **Investimet kapitale:** Përfshihen nga ky program mbështetja për investime kapitale, si ndërtimi i infrastrukturës dhe mjeteve thelbësore për organizatën.
- **Aktivitetet e fokusuara vetëm në punë përgatitore dhe studime:** Nuk do të mbështeten grantet që përbëhen kryesisht ose ekskluzivisht nga puna përgatitore dhe/ose studime paraprake.

Kostot e pranueshme:

Kostot e pranueshme përfaqësojnë ato shpenzime që kontribuojnë drejtpërdrejt në zbatimin e suksesshëm të projektit dhe përputhen me qëllimet dhe objektivat e përcaktuara. Ndërkohë, të kuptuarit e kostove të papranueshme është po aq i rëndësishëm, pasi parandalon keqmenaxhimin ose keqpërdorimin e fondeve që mund të rezultojë në gjoba ose refuzim të kërkesave për rimbursim. Duke identifikuar qartë të dyja kategoritë, aplikantët mund të sigurojnë pajtueshmërinë me udhëzimet financiare, të shmangin komplikimet e panevojshme dhe të ruajnë integritetin e projektit.

Për të qenë të pranueshme, shpenzimet duhet të plotësojnë kriteret si vijojnë:

- **Nevoja për zbatimin dhe arritjen e rezultateve:** Shpenzimet duhet të jenë thelbësore për zbatimin dhe arritjen e rezultateve të pritura në projekt. Kjo do të thotë se ato duhet të lidhen drejtpërdrejt me aktivitetet e projektit dhe objektivat e tij.

- **Arsyeshmëria dhe justifikimi i shpenzimeve:** Shpenzimet duhet të jenë të arsyeshme dhe të justifikueshme në lidhje me objektivat e projektit. Kjo përfshin menaxhimin e shëndoshë financiar, përdorimin e praktikave më të mira të tregut dhe sigurimin e efikasitetit të kostos, që do të thotë se shpenzimet duhet të jenë të përshtatshme dhe të balancuara në raport me rezultatin e synuar.
- **Pajtueshmëria me legjislacionin tatimor:** Shpenzimet duhet të jenë në përputhje me legjislacionin tatimor të Kosovës dhe përfituesit e granteve duhet t'u përmbahen detyrimeve tatimore përkatëse, duke përfshirë regjistrimin dhe pagesën e taksave për çdo aktivitet që ka implikime fiskale.
- **Shpenzimet e krijuara gjatë periudhës së zbatimit të grantit:** Kostot duhet të ndodhin gjatë periudhës së zbatimit të grantit dhe të lidhen me aktivitetet e përfshira në grant.
- **Përfshirja në buxhetin e miratuar:** Shpenzimet duhet të paraqiten dhe miratohen në buxhetin e projektit nga autoritetet përkatëse të programit.
- **Identifikueshmëria dhe gjurmueshmëria:** Shpenzimet duhet të jenë të identifikueshme dhe të gjurmueshme përmes dokumenteve mbështetëse, si faturat, kontratat dhe raportet e tjera financiare që mund të verifikohen nga auditorët ose autoritetet përkatëse.

Kostot e papranueshme:

- **Aktivitetet e llojit të shërbimit, si asistenca teknike:** Aktivitetet që ofrojnë vetëm mbështetje të llojit të shërbimit, si asistenca teknike, pa një komponent të qartë zbatimi ose përfitim qytetar, nuk janë të pranueshme.
- **Fushatat ndërgjegjëse pa veprime përcjellëse:** Fushatat ndërgjegjëse që nuk përfshijnë hapa të qartë pasues për zbatimin ose ndryshimin e qëndrimeve dhe sjelljeve do të përjashtohen.
- **Aktivitetet që varen nga miratimi në nivele të shumta nga palët e treta:** Ndërhyrjet që varen nga miratimi ose autorizimi nga palët e treta dhe që paraqesin rrezik të lartë dështimi ose pamundësie për të arritur rezultate konkrete nuk do të mbështeten.
- **Sub-grantet për palët e treta:** Mbështetja financiare në formën e sub-granteve për palët e treta nuk do të pranohet, përveç kur të gjitha kostot e lidhura mbulohen nga organizata zbatuese.
- **Bursat e studimeve:** Bursat e studimeve për individë nuk do të mbështeten sipas këtij programi.
- **Aktivitetet që gjenerojnë fitim:** Projektet që synojnë kryesisht gjenerimin e fitimit për aplikantin ose palët e treta janë të papërshtatshme.
- **Shlyerja e borxhit:** Përdorimi i fondeve për të shlyer borxhet ekzistuese ose për të mbuluar pagesat e interesit nuk lejohet.
- **Aktivitetet fetare ose të bazuara në besim:** Projektet që promovojnë besime ose praktika specifike fetare janë të përjashtuara.
- **Financimi retroaktiv:** Aktivitetet që tashmë janë përfunduar ose shpenzimet e bëra përpara marrëveshjes së grantit nuk janë të pranueshme për financim.
- **Dënimet administrative:** Kostot që lidhen me gjobat, dënimet ose çështjet/kontestet ligjore janë përgjithësisht të papërshtatshme.
- **Shpenzimet e argëtimit:** Shpenzimet për argëtim, mikpritje ose dhurata nuk mbulohen.
- **Blerja e tokës:** Blerja e tokës ose e pasurive të paluajtshme përjashtohet nga aktivitetet e pranueshme.
- **Aktivitetet jashtë fushëveprimit të programit:** Projektet që nuk përputhen me objektivat dhe prioritetet specifike të programit të financimit janë të papërshtatshme.
- **Pagat dhe tarifat për individët dhe iniciativat e paregjistruara:** Shpenzimet për paga dhe tarifa për individë ose organizata dhe iniciativa që nuk janë të regjistruara zyrtarisht ose të njohura si persona juridikë do të konsiderohen të papërshtatshme.

- **Taksat doganore dhe të importit:** Doganat dhe taksat e importit për mallrat dhe shërbimet që lidhen me aktivitetet e projektit do të konsiderohen shpenzime të papërshtatshme.
- **Pagesat e borxhit ose humbjes:** Shpenzimet për pagesat e borxhit ose humbjes që janë të pajustificuara ose që nuk lidhen drejtpërdrejt me aktivitetet e projektit do të përjashtohen.
- **Tatimi në vlerën e shtuar (TVSH):** Shpenzimet e TVSH-së nuk janë të pranueshme, me përjashtim të rasteve kur TVSH-ja mbulohet nga një donator tjetër ose rimbursohet nga institucionet tatimore.
- **Pagesat e huasë dhe interesit:** Pagesat për huatë dhe interesat, përveç atyre që lidhen drejtpërdrejt me aktivitetet e projektit, nuk do të mbështeten.
- **Tarifat e këmbimit valutor:** Shpenzimet për tarifat e këmbimit valutor do të konsiderohen të papërshtatshme, përveç rasteve kur ato lidhen drejtpërdrejt me aktivitetet e projektit.
- **Amortizimi i pajisjeve:** Amortizimi i pajisjeve dhe aseteve të tjera do të përjashtohet nga shpenzimet e pranueshme.
- **Blerja e tokës ose e pronës së paluajtshme:** Blerja e tokës ose e pasurive të paluajtshme, përveç rasteve kur lidhet drejtpërdrejt me objektivat e projektit dhe miratohet si kosto e pranueshme, do të konsiderohet e papërshtatshme.
- **Blerja e automjeteve ose gjeneratorëve:** Blerja e automjeteve dhe gjeneratorëve do të përjashtohet nga shpenzimet e pranueshme, përveç rasteve kur ato janë thelbësore dhe të justifikuara për zbatimin e aktiviteteve të projektit.
- **Kostot e mbuluara nga donatorët e tjerë:** Shpenzimet që mbulohen nga donatorë të tjerë ose aktivitete të tjera do të përjashtohen nga mbështetja financiare.
- **Kreditë për palët e treta:** Dhënia e kredive për palët e treta nuk është e pranueshme, përveç nëse ato janë të lidhura drejtpërdrejt me aktivitetet e projektit dhe janë miratuar si kosto të pranueshme nga autoritetet përkatëse.

9. PROCESI DHE KRITERET E PËRZGJEDHJES

Ky seksion përshkruan procesin e strukturuar për përzgjedhjen e nën-përfituesve të mundshëm, duke siguruar transparencë dhe përfshirje. Kjo fazë synon të sigurojë një proces transparent dhe gjithëpërfshirës, duke inkurajuar pjesëmarrje të gjerë dhe përgatitje aplikimesh me cilësi të lartë. Kjo qasje e strukturuar siguron që aplikimet të jenë të plota, në përputhje me objektivat e thirrjes dhe të përmbushin kriteret e kërkuara ligjore dhe financiare.

Pas njoftimit zyrtar, do të mbahet një sesion informues për të adresuar pyetjet dhe nevojat e organizatave aplikuese. Sesioni informues do të mbahet online më **24 qershor 2025**. Të gjitha pyetjet dhe përgjigjet gjatë këtij sesioni do të publikohen në faqen zyrtare të internetit të KDI-së.

Përzgjedhja do të bëhet në përputhje me parimet e mëposhtme:

i. Trajtimi i barabartë dhe mosdiskriminimi:

- Të gjithë aplikantët do të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim. Kriteret e vlerësimit do të zbatohen në mënyrë të vazhdueshme për të siguruar trajtim të drejtë dhe kushte të barabarta për të gjithë aplikantët.

ii. Transparenca:

- Kriteret dhe vendimet e përzgjedhjes do të dokumentohen dhe do t'u komunikohen qartë aplikantëve. Kjo siguron që aplikantët të jenë plotësisht të informuar për procesin e përzgjedhjes dhe arsyet e pranimit ose refuzimit të propozimeve.

iii. Menaxhimi i mirëfillët financiar dhe kufizimet e shpenzimeve:

- Është thelbësore që të gjitha projektet të menaxhohen me praktika të mirëfillëta financiare dhe të jenë në përputhje me kufirin e buxhetit prej 12,000 euro për çdo projekt. Ky limit buxhetor siguron që kostot e projektit të jenë të justifikuara dhe të arsyeshme në lidhje me objektivat dhe rezultatet e pritura.

iv. Parandalimi i konfliktit të interesit:

- Të gjithë vlerësuesit do të nënshkruajnë deklaratat kundër konfliktit të interesit për të siguruar vendimmarrje të paanshme bazuar vetëm në merita, pa ndikim nga interesat personale ose të jashtme.

9.1. Shqyrtimi fillestar i aplikacioneve

Gjatë kësaj faze, të gjitha aplikimet do të shqyrtohen për të verifikuar nëse janë përmbushur dhe dorëzuar në pajtim me kriteret e mëposhtme:

- Të gjitha kërkesat administrative dhe teknike të përcaktuara në Aneksin A: Formulari i Aplikimit (kontrolloni pikat nga 1-4 në formularin e aplikimit).
- Dokumentet e detyrueshme (Aneksi A: Formulari i aplikimit, Aneksi B: Formulari i buxhetit dhe Certifikata e Regjistrimit të OJQ-së).
- Shuma e kërkuar (madhësia e grantit mund të jetë midis minimumit 4.000 euro dhe maksimumit 12.000 euro).
- Kohëzgjatja e grantit (Periudha e zbatimit mund të jetë midis katër (4) dhe maksimumit gjashtë (6) muaj. Zbatimi i granteve duhet të fillojë jo më herët se 15 gusht 2025 dhe duhet të përfundojë jo më vonë se 15 shkurt 2026).

Aplikacionet që nuk plotësojnë kriteret e specifikuar do të refuzohen automatikisht. Rezultatet në lidhje me respektimin e kriterëve administrative do t'i komunikohen çdo aplikuesi me shkrim.

9.2. Vlerësimi dhe përzgjedhja

Pas shqyrtimit fillestar, do të fillojë një proces i strukturuar vlerësimi. Procesi i vlerësimit dhe përzgjedhjes do të kryhet nga një komision përzgjedhjeje, i përbërë nga përfaqësues nga partnerët zbatues të projektit, me role të përcaktuara qartë bazuar në ekspertizën e tyre. Propozimet do të vlerësohen bazuar në përputhshmërinë e tyre me objektivat strategjike të programit IW WBT.

Kriteret e vlerësimit dhe pikët e peshuara:

i. Rëndësia me objektivat e thirrjes (40%):

- Ky kriter vlerëson se sa mirë përputhet propozimi me objektivat e përcaktuara në thirrjen për aplikime. Propozimet do të vlerësohen bazuar në rëndësinë e tyre për prioritetet e përcaktuara në thirrje dhe potencialin e tyre për të kontribuar në arritjen e objektivave.

ii. Kapaciteti organizativ për zbatimin e projektit (30%):

- Ky kriter vlerëson aftësitë teknike dhe financiare të aplikantëve. Do t'i kushtohet vëmendje përvojës së organizatës në zbatimin e projekteve të ngjashme dhe burimeve të disponueshme

për të siguruar zbatimin me sukses të projektit. Aplikantët me një histori të provuar të zbatimit dhe menaxhimit me sukses të projektit do të vlerësohen pozitivisht.

iii. Qëndrueshmëria e ndërhyrjes (10%);

- Ky kriter vlerëson qëndrueshmërinë e rezultateve të projektit pas përfundimit të tij. Projektet duhet të kenë një ndikim afatgjatë dhe të japin rezultate që do të mbeten të qëndrueshme përtej përfundimit të periudhës së financimit, duke përfshirë menaxhimin dhe monitorimin e vazhdueshëm të aktiviteteve të projektit.

iv. Efikasiteti i buxhetit (20%);

- Ky kriter vlerëson nëse kostot e propozuara janë të arsyeshme dhe të justifikuara në lidhje me objektivat e projektit. Vlerësimi përfshin një analizë të detajuar të shpenzimeve të propozuara dhe nëse ato janë të nevojshme dhe të përshtatshme për arritjen e rezultateve të dëshiruara. Përdorimi efikas i burimeve është një faktor kyç për një projekt të suksesshëm.

Për t'u kualifikuar për financim, aplikantët duhet të arrijnë një minimum prej 81 pikësh nga 100 të mundshme, me së paku 50% për secilën nga katër kategoritë kryesore të vlerësimit.

Numri përfundimtar i aplikacioneve të përzgjedhura do të varet nga disponueshmëria e fondeve dhe mund të ndryshojë në bazë të konkurrencës dhe cilësisë së aplikacioneve të dorëzuara.

9.3. Njoftimi i aplikantëve

Rezultatet e vlerësimit dhe përzgjedhjes përfundimtare do t'u komunikohen të gjithë aplikantëve. Ky informacion do të përfshijë rezultatet e vlerësimit për secilën kategori dhe do të njoftojë aplikantët për vendimet përfundimtare të përzgjedhjes. Vendimi përfundimtar i përzgjedhjes është përfundimtar dhe nuk mund të apelohej nga aplikantët.

Përmbledhje: Ky proces i vlerësimit dhe përzgjedhjes ofron një mundësi të rëndësishme për organizatat që kërkojnë mbështetje financiare dhe është krijuar për të siguruar që vetëm propozimet më të fuqishme dhe më të qëndrueshme të përzgjidhen për financim. Proces i drejtë, transparent dhe i bazuar në kritere të qarta dhe të matshme, për të siguruar që fondet të përdoren në mënyrë efikase dhe të barabartë.

10. MENTORIMI DHE RAPORTIMI

Konzorciumi Integrity Watch do të angazhohet në mentorim, konkretisht në kërkesat e menaxhimit të projektit dhe financiar, vizibilitetit dhe monitorimit gjatë zbatimit të projekteve të përzgjedhura. Konsorciumi do të organizojë vizita në terren, intervista ose takime të përbashkëta me nën-përfituesit gjatë zbatimit për të mbështetur aktivitetet e tyre dhe për të monitoruar ndikimin e sub-granteve në kontekstin më të gjerë të zbatimit të veprimit.

Çdo përfituesi të sub-grantit i kërkohet të dorëzojë raporte përshkruese/narrative dhe financiare në baza mujore. Raporti përfundimtar mbi zbatimin e projektit do të dorëzohet jo më vonë se një muaj pas përfundimit të projektit. Datat e sakta të periudhave të raportimit do të rregullohen në kontratë.